

STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“LIFE IN ALBANIA” shpk

FORMIMI NENI 1

Ne baze te ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “ nr.9901, date 14.04.2008, te ligjit nr. 129/2014, per disa shtesa te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 dhe ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit “,perpilohet statuti i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“LIFE IN ALBANIA” shpk**, me ortaket themelues:

1.Klevis Kapllaj , atesia Gjon, i datelindjes 30.04.1988, lindur ne Lezhe dhe banues ne Lezhe, rrethi Lezhe, mbajtes i kartes se identitetit me nr. I80430053H

2 Michele Calzolari, atesia Giancarlo , i datelindjes 06.08.1981, lindur ne Carrara-Itali dhe banues ne Lezhe, rrethi Lezhe, mbajtes i kartes se identitetit me nr. YA6696001

VENDQENDRIMI NENI 2

Selia e shoqerise do te jete:

LEZHE Lagjja Beselidhja, Rruga Shtraus, Pallati Nr.11, kati I-re, Ap.Nr.4.

Perfaqesuesi ligjor ka fuqi te transferoje seline ligjore ne nje adrese tjeter brenda te njejtës Bashki, si dhe te ngreje edhe tjeterkund,zyra,fabrika, agjensi dhe perfaqesi dhe t'i mbylle, banesa e ortakeve, ne raportet me shoqerine ose ndermjet tyre, eshte ajo qe rezulton ne Regjistrin e Firmave, ku eventualisht duhet te shenohen edhe numri i telefaksit dhe adresa e postes elektronike.

KOHEZGJATJA NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat. Por shoqeria mund te ndryshoje kete afat me vendim te themeluesve te saj.



NENI 4

Veprimtaria e shoqerise do te zhvillohet ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti, te Aktit Te Themelimit dhe e mbeshtetur ne Legjislacionin Shqiptare ne fuqi si dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te ketyre ligjeve.

NENI 5

Shoqeria vepron ne rregjimin e prones private dhe merr persiper vete te gjitha te drejttat dhe detyrimet. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontaktore brenda kapitalit te saj. Ortaket bartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise brenda nivelit te shumes se investuar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE NENI 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

Ne fushen e turizmit, Import-Eksport pije alkolike, Verera, Artikuj te ndryshem.
Agjensi Imobiliare.

Megjithate shoqeria ka te drejte qe te ndryshoje emertimin, seline, kohezgjatjen dhe te ndryshoje apo te shtoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te Asamblese se ortakeve prane Qendres Kombetare te Biznesit si dhe shoqeria mund te marre persiper perfaqesine, te hape agjensi, te ngre filial ne te gjith vendin.

KAPITALI I SHOQERISE NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000.000 lek i formuar nga kontributi i ortakeve te shoqerise.

Neni 8

Ortaket dhe themeluesit e Shoqerise jane :

1. **Klevis Kapllaj** ka 49 % te aksioneve , me kuote te barabarte me 490 000 lek , 1 Kuote
2. **Michele Calzolari** ka 51 % te aksioneve , me kuote te barabarte me 510 000 lek , 1 Kuote



Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit qe do te marre Asambleja e Ortakeve te shoqerise.

Aktiviteti ne kete shoqeri nuk e pengon ortakun qe te kete te drejta pronesie jashte kesaj shoqerie.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve jashte kesaj shoqerie.

NENI 9

ADMINISTRATORI

Emertimi, shkarkimi, te drejtat dhe detyrimet

1. Administratori i shoqerise eshte Z. **Klevis Kapllaj**, per nje afat 5 vjecar me te drejte riperseritje
2. Administratori i kesaj shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 nuk mund te emerohet si Administrator i nje shoqerie te kontrolluar dhe anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
3. Administratori ka te drejte dhe detyrohet te :
 - a. Kryeje te gjithë veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Ortakeve .
 - b. Perfaqeson shoqerine tregtare.
 - c. Kujdeset per mbajtjen e sakte dhe te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise.
 - d. Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve. I paraqet keto dokumenta perpara Asamblese se ortakeve te perbere ortaket per miratim.
 - e. Krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
 - f. Kryen rregjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise , sic parashikohet ne ligjin "Per Qendren Kombetare te Biznesit".
 - g. Raporton perpara Asamblese se ortakeve te perbere nga tre ortake ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe ne realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
 - h. Kryen detyra te tjera te percaktuar ne ligj dhe ne statut.
4. Ne rastet e parashikuar nga pikat 3 dhe 5 te nenit 82 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" , administratori eshte i detyruar te therrase Asamblene e Ortakeve te perbere nga dy ortake.
5. Nese asambleja e ortakeve emerom ne shume se nje administrator ata e administrojne bashkarisht shoqerine. Statuti ose rregulloret e tjera te miratuara nga Asambleja e ortakeve mund te parashikojne ndryshe.



6. Asambleja e ortakëve e përbërë nga ortakët mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statute apo marrëveshjet e tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këto të drejta. Paditë që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqëritë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi. Administratori mban përgjegjësi vete për ruajtjen e karakterit të fshtësisë së aktivitetit dhe të dokumentacioneve të shoqërisë.

NENI 10

Shoqëria është përgjegjëse vetëm për kapitalin dhe mjetet që disponon dhe asgjë më tepër.

BILANCI DHE TË ARDHURAT NENI 11

Shoqëria përcakton fondet e saj, fondin themeltar dhe atë rezervë. Gjate ushtrimit të veprimtarisë mund të të caktohen edhe fonde të tjera. Fondi themeltar i shoqërisë formohet nga mjetet e investuara nga ortakët e shoqërisë. Shoqëria shfrytëzon këto fonde për kryerjen e punëve të veprimtarisë së saj si dhe për të mbuluar rreziqet pa shfrytëzuar fondin rezervë. Përberja dhe shumata e çdo fondi caktohen dhe kontrollohen nga ortakët e shoqërisë.

NENI 12

Kur shoqëria pushon aktivitetin e saj, pasitë shlyhen të gjitha detyrimet që ka, pjesa e mbetur e kapitalit dhe të të ardhurave i mbeten tërësisht ortakëve të shoqërisë.

NENI 13

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqërisë mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhe ushtrimore, administratori i shoqërisë nxjerr bilancin kontabel dhe rezultatin Humbje – Fitim si dhe përpilon raportet përkatëse me shkrim. Bilanci vjetor duhet të paraqitet brenda muajit Mars të vitit pasardhës.



NENI 14

Te ardhurat neto , pas vecimit te fondeve te permenduara me siper , mbeten ne perdorim te shoqerise.

NENI 15

Organet e shoqerise jane :

1. Asamblea e Ortakeve.
2. Komisioni i eksperteve kontabel. Detyra e komisionit te eksperteve kontabel caktohet ne perputhje me ligjin kontabel.

NENI 16

Asamblea e Ortakeve eshte organi vendimor i shoqerise dhe ortaket e shoqerise nepermjet vendimeve qe marrin realizojne te gjithe aktivitetin e veprimtarise se shoqerise. Ato percaktojne drejtimet kryesore, vendosin bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, per pranimin ne shoqeri te ortakeve te tjere, te gjitha keto ne baze te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerit Tregtare".

NENI 17

Asamblea e Ortakeve lidh kontrata me persona fizik e juridike shteteror dhe privat, vendas e te huaj si dhe vendos per drejtimet e aktivitetit te shoqerise.

Ai vendos per fuqine punetore, per pagat e tyre duke lidhur kontrat ne perputhje me ligjin.

SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 18

Shoqeria mund te shperndahet me likujdimin e saj. Ne rastin e likujdimit te shoqerise, emertimi i saj do te pasohet nga shenimi "shoqeri ne likujdim e siper".

NENI 19

Shperndarja e shoqerise mund te vije per cfaredo arsye. Per kete Asamblea e Ortakeve vendos per menyren e likujdimit te saj. Caktohet nje ose disa likujdator. Ky ben kujdes qe shoqeria te likujdoje me pare detyrimet qe ajo u ka personave te trete fizik e juridik.

NENI 20

Kapitali i shoqerise kur vdes njeri nga otaket i mbetet sipas ligjit per trashegimime, trashegimtareve te tij ligjor. Pjesen takuese te ortakut ne shoqeri e trashegojne trashegimtarete e tij ligjor.



NENI 21

Administratoret kane te drejt te emerrojne ekonomist dhe avokat si dhe ti japin te drejta personave te trete qe te veprojne ne emer e per llogari te tyre, ne pershtatje te plote me ligjin mbi perfaqesimin.

NENI 22

Shoqeria deklarohet e krijuar dhe fiton zotesin juridike me rregjistrimin e saj prane Qendres Kombetare te Biznesit, kurse zotesine per te vepruar e fiton mbas rregjistrimit ne Degen e Tatim Taksave.

NENI 23

Shoqeria ka vulen me permbajtjen “**LIFE IN ALBANIA** “ shpk.

NENI 24

Persa nuk eshte shkruar ne kete statut i referohet plotesimeve nga vendimi i Asamblese se Ortakeve si dhe ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

NENI 25

Ky statut u reduktua ne tre kopje, njera depozitohet ne Qendren Kombetare te Biznesit, nje ne Degen e Tatim Taksave dhe nje kopje mbahet ne dokumentacionin e shoqerise.

Lezhe, me 1.09.2023

ORTAKET THEMELUES

**Klevis Kapllaj
Michele Calzolari**

